

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE**

**Sarande, me 25.11.2020**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Për: "MANE/S" Sh.p.k**

**NIPT J64103865K**

Procedura e prokurimit : Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-79329-11-20-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës : Objekti : **"ZEVENDESIM LINJE UJESJELLESI NE SHETITORE TUB DN280, PN20, L=450m"**, **Fondi Limit : 6 799 000 (gjashtemilion shtateqind nentehjete e nentemije) leke pa tvsh**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **"MANE/S" shpk NIPT J64103865K** me oferte **6,795,073(gjashtemilion shtateqind nentehjete e pesemije e shtatedhjete e tre) leke pa TVSH**
2. **"MF INVEST GROUP" shpk NIPT L71830010R** me oferte **6,797,550(gjashtemilion shtateqind nentehjete e shtatemije e peseqind e pesedhjete) leke pa TVSH**
3. **"ILIRIA/D" shpk NIPT J66702510D** me oferte **6,798,213(gjashtemilion shtateqind nentehjete e tetemije e dyqind e trembedhjete) leke pa TVSH**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **"MF INVEST GROUP" shpk NIPT L71830010R**
2. **"ILIRIA/D" shpk NIPT J66702510D**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

## **1. Operatori Ekonomik “MF INVEST GROUP” shpk**

### **Kriteret e Vecanta te Kualifikimit**

#### **1. Per Piken 1. e).**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga OE, rezulton se per përmbushjen e kësaj pike OE nuk ka paraqitur “Deklarat mbi disponushmerin e mjeteve” Shtojca 9.

#### **2. Per Piken 2.2.1**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE per përmbushjen e kësaj pike, rezulton se: Shoqeria “MF INVEST GROUP” ka paraqitur dokumentacion e kërkuar sipas pikës 2.2.1 per punët e ngjashme.

1. Ndertim Pike Logjistike Agrobiznesi Zyra dhe Ambiente Ndhimese.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne brendësi per këte objekt rezulton se:

Se ky objekt nuk ka per natyre te punës se ngjashme objektin e prokuruar nga AK, ky objekt eshte punim civil, qe nuk eshte i parashikuar ne piken NP 7 per “ Ujesjellsa, Gazesjellsa, vajesjellsa dhe veprakullimi, per me tepër nëse analizon zërat konkret ne situacionin e punës se ngjashme te paraqitur nga OE, rezulton se shuma e instalimeve hidrosanitare eshte ne vlere me te vogël se 50% e vlerës se përlloritur te kontratës qe prokurohet.

Si rezultat ky OE me dokumentacionin e dorezuar nuk harrine te përmbushe kërkesat e pikës **2.3.1 a) dhe b)**

**Sa më sipër, KVO vlerëson se OE nuk vërteton se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara ne piken a) dhe b) te pikës 2.3.1. te “Kritereve te Veçanta” te hartuar nga AK.**

#### **3. Per Piken 2.3.2**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka te punësuar me kontrat nje person te Licencuar per “Zbatim Punimesh Restaurimi”.

#### **4. Per Piken 2.3.4**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka te punësuar me kontrat pune dhe figuron ne liste-pagesat si Drejtues Teknik 1 Inxhinier. Hidroteknik.

### **5. Per Piken 2.3.5**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka te punësuar me kontrata pune, personelin e kerkuar dhe te certifikuar me kualifikimin teknik përkatës, manovrator, hekurkthyes, teknik ndërtimi dhe mekanik.

### **6. Per Piken 2.3.6**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka te punësuar me kontrat pune, nje person te certifikuar me “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne shendetit ne pune”

### **7. Per Piken 2.3.7**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka te punësuar me kontrat pune, nje person te certifikuar per “ Testimin e Cilesise te Materialeve”

### **8. Per Piken 2.3.8**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga ky OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar certifikat e kërkuara sipas standartit ISO per : ISO39001:2012, ISO 1452-1:2009 dhe EN-ISO 3834-2:2006.

### **9. Per Piken 2.3.9**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka ne pronësi apo me qera mjetet e kerkuara si: Aparat elektrofuzion per ngjitje tubash, Aparat Testimi lëngjesh, Pirun ngritës, minieskavator, Asfaltoprere, Kompresor dhe Kriko mbi pjastër.

### **10. Per Piken 2.3.10**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE ka dorëzuar dokument per te vërtetuar se ka ne pronësi vetëm paisjet mbrojtëse si kokore dhe jelek dhe asnjë prej paisjeve mbrojtëse te tjera, te kërkuara ne kërkesat e kësaj pike.

## **11. Per Piken 2.3.10**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk eshte i Autorizuar nga asnjë kompani per furnizimin me tuba HDPE100 DN280 20bar, e cila përmbush specifikat e testimit te tubit ne presion dhe eshte e pajisur me certifikat ISO 9001 per cilesine e matrialit.

**Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “MF INVEST GROUP” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.**

## **2. Operatori Ekonomik “ILIRIA/D” shpk**

### **Kriteret e Vecanta te Kualifikimit**

#### **1. Per Piken 1.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga OE, rezulton se per përmbushjen e kësaj pike OE ka paraqitur vetëm “Deklarate mbi disponushmerin e mjeteve” Shtojca 9 dhe asnjë nga deklaratat e tjera te përcaktuar ne kërkesat e kësaj pike.

#### **2. Per Piken 2.2.1**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE per përmbushjen e kësaj pike, rezulton se: Shoqeria “ILIRIA/D” ka paraqitur dokumentacion e kërkuar sipas pikës 2.2.1 per punët e ngjashme.

1. Rikonstrukcion RrugeFshati Rusan.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne brendësi per këte objekt rezulton se:

Se ky objekt nuk ka per natyre te punës se ngjashme objektin e prokuruar nga AK, ky objekt eshte punim civil, qe nuk eshte i parashikuar ne piken NP 7 per “ Ujesjellsa, Gazesjellsa, vajesjellsa dhe veprakullimi, per me tepër nëse analizon zërat konkret ne situacionin e punës se ngjashme te paraqitur nga OE, rezulton se zërat qe zene peshën kryesore te preventivit te prokuruar nuk gjejnë pasqyrim ne situacionin perfundimtar te kësaj pune te ngjashme.

Si rezultat, ky OE me dokumentacionin e dorëzuar nuk harrine te përmbushe kërkesat e pikës **2.3.1 a) dhe b)**

**Sa më sipër, KVO vlerëson se OE nuk vërtetohet se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në pikën a) dhe b) të pikës 2.3.1. të “Kritereve të Veçanta” të hartuar nga AK.**

## **2. Per Piken 2.3.1**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezulton se OE nuk ka si pika të licencës së tij të zbatimit, pikat NP11 dhe NP12 sipas përcaktimeve të kësaj pike të DST-së të hartuar nga AK

## **3. Per Piken 2.3.4**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të vërtetuar se ka të punësuar me kontrata pune dhe figurojnë në liste-pagesat si Drejtues Teknik 1 Inxhinier. Hidroteknik, Inxhinier Mjedisi dhe Inxhinier Elektrik.

## **4. Per Piken 2.3.5**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezulton se OE ka dorëzuar dokumentacion për të vërtetuar se ka të punësuar me kontrata pune, personelin e kërkuar dhe të certifikuar me kualifikimin teknik përkatës, vetëm për specialistet manovrator.

## **5. Per Piken 2.3.6**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të vërtetuar se ka të punësuar me kontrat pune, një person të certifikuar me “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen në shëndetin në punë”

## **6. Per Piken 2.3.7**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të vërtetuar se ka të punësuar me kontrat pune, një person të certifikuar për “Testimin e Cilesisë të Materialeve”

## **7. Per Piken 2.3.8**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar certifikatë të kërkuara sipas standartit ISO për : ISO 1452-1:2009 dhe EN-ISO 3834-2:2006.

### **8. Per Piken 2.3.9**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka ne pronësi apo me qera, mjetet e kerkuar si: Aparat elektrofuzion per ngjitje tubash, Aparat Testimi lëngjesh, Pirun ngritës, Eskavator me çekiç, Minifadrom(Bobcat), minieskavator, Rul Gome Hekur, Fadrom me goma, Asfaltopres, Kompresor Gjenerator dhe Kriko mbi pjastër.

### **9. Per Piken 2.3.10**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument per te vërtetuar se ka ne pronësi apo me qera mjetet e kerkuar ne pike 2.3.10

### **10. Per Piken 2.3.10**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se OE nuk eshte i Autorizuar nga asnjë kompani per furnizimin me tuba HDPE100 DN280 20bar, e cila përmbush specifikat e testimit te tubit dhe eshte e pajisur me certifikat ISO 9001 per cilesine e matrialit.

**Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Nenit 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “ILIRIA/D” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqerine “MANE/S” Sh.p.k, NIPT J64103865K, me adresë : Sarande, Lagjia nr. 2, P. 46,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **6,795,073(gjashtemilion shtateqind nentedhjete e pesemije e shtatedhjete e tre) leke** pa TVSH

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarande* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe te paraqiteni per nenshkrimin e kontrates, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 1(nje) dite nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.11.2020